



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

01 Nr. 176/25 Dt. 11.03.2025

**Procesverbali për Projekt-Strategjinë për sigurinë në institucionet  
edukative arsimore në Komunën e Prizrenit**

**Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **27.02.2025** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/Njoftim-per-organizimin-e-KONSULTIMIT-publik-per-Projekt-Strategjine-per-sigurine-ne-institucionet-edukative-arsimore-ne-Komunen-e-Prizrenit-shq-bosh-tur-rom.pdf>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42777>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-strategjine-per-sigurine-ne-institucionet-edukative-arsimore-ne-komunen-e-prizrenit/>

Me 28.02.2025 është publikuar njoftimin në rrjetin social facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1A149RpMVc/>

**Me 28.02.2025**, njoftimi dhe projekt-strategjia (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

**Me 10.03.2025**, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-strategjine-per-sigurine-ne-institucionet-edukative-arsimore-ne-komunen-e-prizrenit/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1AF6PnLLPX/>

## **Konsultimi ka filluar në orën 11:05**

**Ymer Berisha**-Udhëheqësi i Njësisë për Komunikim me Publikun, ka bërë hapjen e konsultimit duke thënë se ju falënderoj që jeni pjesë e këtij konsultimi që ka të bëjë me draft Strategjinë për sigurinë në shkolla. Pas elaboratit të këtij drafti e kaloi fjalën tek pjesëmarrësit në këtë takim.

**Luljeta Veseli-Gutaj**-drejtoreshë e Drejtorisë Komunale të Arsimit, ishte e para nga pjesëmarrësit që e mori fjalën, dhe në detaje bëri përshkrimin e dokumentit. Drejtoresha vazhdoi me analitiken e dokumentit për sigurinë fizike të objekteve shkollore.

E theksoi se autoriteti kryesor në shkolla është nxënësi.

Strategjia për siguri është e ndarë në kategori:

- 1.Siguria fizike e objekteve, sigurimi i ndërtesës, monitorimi i hyrje daljes, pajisje për siguri ndaj zjarrit etj.
- 2.Shëndeti dhe siguria mjedisore, mbajtja e higjienës, sigurimi i ndriçimit etj.
- 3.Siguria kibernetike me theks mbrojtja e të dhënave personale, fitimi i qasjes ne internet, mbrojtja nga sulmet kibernetike etj.
- 4.Shëndeti mendor, sigurimi emocional, mbështetje psikologjike, parandalim i bullizmit, mjedis mbështetës etj.
- 5.Menaxhimi dhe reagimi ndaj krizave me theks trajnimi i nxënësve dhe mësimitdhënësve.
- 6.Sigurimi i transportit me autobusë shkollore, monitorimi i stacioneve, siguria e këmbësorëve pranë objekteve shkollore etj.
- 7.Parandalimi i abuzimit me substanca(aktivitete, programe ndërgjegjësimiti etj)
- 8.Menaxhimi i disiplinës dhe sjelljes(promovimi i sjelljes, menaxhimi i sjelljeve të këqija etj)
- 9.Barazia dhe gjithë përfshirja(zhvillimi i programeve për ndërgjegjësimit)
- 10.Përfshirja e komunitetit(forumet e hapura me komunitet, programe me OJQ, angazhimi i prindërve në vendimmarrje).

Më pas vazhdoi përsëri Y.Ymer Berisha dhe tregoi që dokumenti është i publikuar ne Web Faqe dhe të maksimizojmë komunikimin online. Deri më 14 Mars mund të dërgojnë ide që të plotësohet dokumenti. Theksoi që dokumenti është në përputhje me nxënës, prindër dhe menaxhmentin e shkollës.

**Vlora Karavidaj**-Drejtoreshë- Ritheksoi që na ndihmon dokumenti për siguri nëpër shkolla. E lartcekura dha një propozim që këtij dokumenti ti shtohet edhe Infrastruktura shkollore për fëmijët me aftësi të kufizuara, nëpër hapësira jashtë shkollës, brenda saj, në klasa, në tualete etj.

**Bashkim Rakaj**-Punëtor social- i dha 4 propozime që ti shtohen këtij dokumenti;

- 1.Pregatitja e një personi që ka me mbikëqyrë sigurinë nëpër shkolla
- 2.Një person të merret vetëm me menaxhimin e çështjeve problematike
- 3.Ushqimi të jepet nëpër shkolla, të krijohen ambiente që fëmijët të mos kenë nevojë me dal jashtë objektit shkollor.
- 4.Trajtimi i shëndetit mendor të fëmijëve me sjellje devijonte, mbikëqyrja përmes punëtorit social dhe psikologëve nëpër shkolla.

**Mehdi Krasniqi**-Drejtor-Edhe ky mendoi që strategjisë së sigurisë duhet ti shtohen edhe disa pika si, vendosja e pengesave në rrugë në afërsi të objektit shkollor ku ai është drejtor. E ceku edhe një pikë të rëndësishme që nxënësit që vijnë nga fshatrat si Zhupa të iu sigurohet transport deri në shkollë( sepse autobusi që i sjell në qytet i le larg nga shkolla)

**Tringa Kasemi**- nga OJQ tha që duhet te jemi transparent dhe të shohim kush janë anëtarët e komisionit që e kanë hartuar këtë strategji. Poashtu theksoi që duhet ta digjmë sa kemi buxhet për ti realizuar gjitha këto pika të planit të strategjisë për sigurinë. Theks i vuri duhanpirjes në ambientet shkollore, monitorimi nga mësimdhënësit dhe inspektoriati në afërsi te dyqanet që shesin.

**Shqipe Shatri**-Sekretare e shkollës Gjonaj i dha disa propozime si në vijim

- 1.të investohet në shkallë emergjente nëpër shkolla
- 2.të shtohet numri i psikologëve shkollorë nëpër fshatra
- 3.Ndalimi i postimeve dhe komenteve nga ana e mësimdhënësve nëpër rrjete sociale me qëllim fyere e sharje ndaj punës së njëri tjetrit.

**Nexhdet Mrasori**-Komandant Policie-Edhe zyrtari në fjalë nga rradhët e policie i dha disa propozime të disa pikave si në vijim dhe e ceku punën dhe bashkëpunimin

- 1.Me qenë prezent edhe drejtorja e inspektoriatit dhe shërbimeve publike kur mbahen dëgjime të tilla
- 2.Bashkëpunim kemi gjithmonë në patrullim nëpër shkolla.(Ka ligjërata nëpër shkolla në koordinim me DKA për bullizmin, lëndët narkotike etj)

E ceku një gjë me rëndësi që siguri nëpër shkolla të kryhet nga komuna dhe të mos jetë nga prindërit.

Poashtu e përmendi që rrethojat nëpër shkolla të vendosen sa më parë aty ku ka nevojë.

**Simon Veseli**-ish Drejtor Velezhë-E ceku që këshilli për siguri të bëhet edhe me përfaqësues të fshatrave dhe drejtorë të gjitha shkollave dhe të mbahet evidenca kur dikush mungon në takimet e këshillit.

**Haxhi Kabashi**-Kapiten në Stacionin e Policisë në Veri-Falënderoi gjithë pjesëmarrësit dhe shprehi si gjithmonë bashkëpunimin e policisë së Kosovës me qytetarë.

**Linda Simitqiu-OJQ**-parashtrori pyetje se kush i mbikëqyr se sa po punohet për implementimin e këtij plani për strategjinë.

Z.Ymer Berisha iu përgjigj pyetjes së parafolëses dhe tha se kuvendarët bashkë me akterët tjerë mund të shikojnë punën e planit dhe të japin raport për zbatim ose moszbatim.

Drejtoresha Z.Luljeta Veselaj-Gutaj iu dha përgjigje atyre që ishin të interesuar të dinë se sa do të jetë buxheti për implementim të kësaj strategjie. Së pari e cekti që ai do të votohet, legjitimohet dhe mandej ndahet buxheti për të. Poashtu e theksoi që kemi edhe OJQ Kombëtare dhe Ndërkombëtare që japin mbështetje.

Në fund e mori fjalën Reshit Kushaj Kryetari i Komisionit për Siguri dhe theksoi që strategjia është mjaft mirë e punuar dhe e konsultuar edhe me strategjitë ne rajon. Dhe theksoi që çdo parregullsi brenda dhe jashtë shkollave ka dispozitë administrative.

E përfundoi udhëheqësi i takimit Z.Ymer Berisha duke i falënderuar të gjithë pjesëmarrësit në takim dhe me shpresë për bashkëpunim me të gjithë akterët e arsimit në Prizren dhe rrethinë në implementimin e këtij plani për sigurinë në institucione edukativo arsimore në Komunën e Prizrenit.

Në këtë vegëz:

[https://www.facebook.com/watch/live/?ref=watch\\_permalink&v=620241530623918&rdid=mL6IGiAoKDluBK15](https://www.facebook.com/watch/live/?ref=watch_permalink&v=620241530623918&rdid=mL6IGiAoKDluBK15) , mund të gjeni video incizimin e konsultimit publik.

**Konsultimi ka përfunduar në orën 12:02**

Procesmbajtës:

Kaltrina Dakaj